



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Arsim
Uprava za Nauku/Department of Education

DATA	29.07.2020
NR.	05/ 269
NGA	Drejtoresha e DKA-së, znj. Agime Roshaj
LËNDA	N J O F T I M



Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.01/10 të datës 05.07.2020 për ndërmarrjen e masave anti COVID, duke u bazuar në konkursin me nr protokoli 05/263 të datës 17.07.2020 për bursa të studentëve;

- Drejtoria Komuna e Arsimit i njofton të gjithë studentët të cilët për arsye objektive nuk kanë arritur të plotësojnë dokumentacionin e fakultetit, pasi që nesër (datë 30.07.2020) është data e fundit, **u lejohet që të aplikojnë pa dokumentacionin të cilin ua lëshon fakulteti** me arsyetimin që i njëjti të plotësohet deri më datë **25.08.2020** ora 16:00.

Në rast të mos plotësimit eventual të dokumentacioni, aplikacioni nuk do të shqyrtohet.

Drejtoria Komunale e Arsimit, respektivisht Komisioni Komunal për Ndarjen e Bursave do të jenë në kontakt edhe me Universitetet/Kolegjet për të marrë informacione shtesë lidhur me mundësinë e lëshimit të dokumentacionit për studentë.

Arsyetim

Kjo mundësi u lejohet studentëve ngase ka pasur kërkesa të shumta përkundër afatit 15 ditor të konkursit, nuk kanë arritur t'i kompletojnë dokumentacionet e kërkuara me konkurs e me theks të veçantë dokumentet që lëshohen nga Fakultetet si pasojë e masave të ndërmarra nga Qeveria për Parandalimin e përhapjes së COVID-19.